



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:007738
Datë: 18.01.2024
Numri i dokumentit: 05206907

C-IV-14-6843

Ankuesi

O K- nga G, të cilin e përfaqësojnë sipas autorizimit avokatët: N B, Vushtrri, Sh R, Prishtinë, B E, Prishtinë, si dhe Mr.sc.iuris M L, Prishtinë
kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit për N.SH. “Universal” (në likuidim)- Rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 18 janar 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Ankuesi i bartë shpenzimet gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 30 tetor 2014, ankuesi parashtrij ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN037-0094, të datës 25.07.2013, me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim të pagave të papaguara në shumën prej 1,360.00 Euro nga NSH ”Universal” (në likuidim).

Me 21 shtator 2023, Gjykata lëshoj për njërin nga përfaqësuesit e ankuesit, vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar ankuesin se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.4 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Ankuesi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Në vazhdim dispozita 253.5 e LPK-së parasheh: *Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 21 shtator 2023, Gjykata përmes vërejtjes kërkoj nga përfaqësuesi i ankuesit, që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankuesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Vërejtja ishte pranuar nga përfaqësuesi i ankuesit, mirëpo ai nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore të lartcekura ankesa konsiderohet e tërhequr.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), ankuesi si palë e pasuksesshme do të mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha, Gjyqtare